

E DREJTA PËR NJË PROCES TË RREGULLT GJYQËSOR

Gjyqësori është institucion që duhet t'i garantojë individit të drejtën e tij për t'u dëgjuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.

Parimi i pavarësisë dhe paansisë së gjyqësorit vjen nga parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Në nivel rajonal në nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet e drejta për një proces të rregullt ligjor: *"Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij"*.

"Ky raport u prodhua nga Fondacioni Qendra Europiane në kuadër të projektit "Procesi i rregullt ligjor si kusht për funksionimin e shtetit të së drejtës" si pjesë e skemës së granteve të projektit "Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Qendra Europiane dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara"



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



FLETË INFORMUESE

Për më shumë informacion na kontaktoni në:

QENDRA EUROPIANE

Rr. Vaso Pasha
P. 20, Ap. 57, 1001
Tiranë, Shqipëri

MONITORIMI I GJYKIMEVE ADMINISTRATIVE NË GJYKATAT ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË DHE NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT

TË DHËNA MBI PROJEKTIN



Hartimi i një raporti mbi funksionimin e gjykatave administrative të shkallës së parë dhe apelit në Shqipëri, lidhur me efikasitetin dhe veprimtarinë e këtyre gjykatave.



7 vëzhgues me formim juridik u përzgjedhën dhe trajnuan nga Qendra Europiane mbi metodologjinë e monitorimit të drejtësisë administrative.



6 muaj monitorim prej janarit deri në qershor të vitit 2018 të gjashtë Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë në Tiranë, Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër dhe Vlorë, si dhe të Gjykatës Administrative të Apelit në Tiranë.



Janë monitoruar gjithësej 192 çështje. Janë monitoruar gjithashtu mbi 550 seanca gjyqësore.

REKOMANDIME

- » Pala e paditur duhet që të jetë më aktive duke i'u përgjigjur kërkesave të Gjykatës Administrative në mënyrë, që të mos kemi shtyerje të procesit, të cilat sjellin kosto të larta.
- » Duhet të përmirësohen njohuritë dhe kapacitetet e litiguesve mbi procesin gjyqësor administrativ: funksionimin e Gjykatave Administrative, padive dhe afateve ku mund të ngrihen këto padi në këtë gjykatë.
- » Shkolla e Avokatisë të ofrojë mundësi trajnimi vazhdues mbi funksionimin e gjyqësorit administrativ për avokatët e rinj dhe ata ekzistues.
- » Nevojitet të hartohet një rregullore për standardizimin e kalendarit javor për të gjithë gjykatat administrative.
- » Nevojitet përmirësimi i portaleve online të gjykatave, duke bërë të mundur përditësimin e informacionit në to dhe përmirësimin e dobishmërisë së tyre.
- » Nevojitet rritje e numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Administrative të Apelit, për shkak se numri aktual i tyre nuk i përgjigjet volumit të çështjeve të akimuara apo dhe numrit të çështjeve që kjo gjykatë i shqyrton si juridiksion fillestar.
- » Për të shmangur problemin e mospërballimit të numrit të çështjeve duhet një ndryshim ligjor i afateve kohore i parashikuar në Ligjin për Gjykatat Administrative (LGJA) për gjykimin dhe vendimarrjen në apel.
- » Duhet gjetur një ekuilibër në mënyrë që të ruhet ritmi i gjykimit dhe cilësia e procesit gjyqësor.
- » Rekomandohet të propozohen ndryshime në LGJA me qëllim shmangien e rrezikut për konsolidimin e praktikës që ndiqet duke i përafëruar proceset administrative me ato civile, si dhe për të zgjidhur çështjen e vonesave në gjykimet e apelit.

